REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME KËLCYRË SH.A**
**AKSIONARI**

Këlcyrë më 25/05/2023

## VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

**Nr. 02, date 25/05/ 2023**

Në mbështetje të, Ligjit, Nr. 9901/2008 " Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" Neni 135, pika 2/c si dhe të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë Sh.a, sot, më datë 25/05/2023, Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë Sh.a, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me K492252204A, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga likuidatori dhe administratori i shoqërisë zoti, Elidon Beqiri për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit te ditës, Asambleja vëren:**

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Këlcyrë Sh.a nuk zhvillon më aktivitet ekonomik e administrativ dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 2422Rep. dhe Nr. 798 Kol, datë 02.11.2022 midis shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë Sh.a dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 31.12.2022, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.
Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Ortaku i Vetëm vendosi:**

(1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
(2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
(3) Emërimin e Z. Elidon Beqiri si likuidator të shoqërisë.

(4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONAREVE**
**AKSIONAR I VETEM**
**PERFAQESUAR NGA**

**KRYETARI**

**Klement NDONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHKIA KËLCYRË